

MINISTRIA E INDUSTRISE DHE ENERGJETIKES
Drejtoria e Përgjithshme e Hidrokarbureve

U R D H E R

Nr. 166, Datë 01/07/2004

“PER KONTROLLIN E CILESISE, MENYREN E MARRJES SE MOSTRES, SASINE E SAJ, PAGESAT DHE DOKUMENTACIONIN PERKATES, SI DHE PER KONTROLLIN DHE RESPEKTIMIN TE NORMAVE E KUSHTEVE TEKNIKE NE INTALIMET E NAFTES, GAZIT DHE NENPRODUKTEVE TE TYRE”

Mbështetur në ligjin nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, në ligjin nr.9218, datë 08.04.2004 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr.8450, datë 24.02.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, në VKM nr.130, datë 18.3.1999 “Për Inspektoratin Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të tyre” me ndryshimet përkatëse, në VKM nr.646, datë 12.12.2002 dhe në VKM nr.281, datë 08.02.2003 “Për miratimin e standardeve dhe kushteve teknike të projektimit dhe të zbatimit në fushat e industrisë dhe të energjetikës, të cilat duhet të marrin statusin “Rregulla Teknike” të detyrueshme për zbatim”, si dhe në VKM nr.170, datë 25.04.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe kushteve për dhënien e lejeve dhe të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”,

U R D H E R O J:

I. Kryerja e kontrollit për cilësinë:

1.- Kontrolli i cilësisë të naftës, gazit e nënprodukteve të tyre, të bëhet konform “rregullave teknike” të detyrueshme për zbatim, Lidhje Nr.1 pika 1 e VKM nr.646, datë 12.12.2002 dhe të VKM nr.281, datë 8.5.2003, në Laboratorin Qendror të Kontrollit të Inspektoratit Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre në Tiranë, edhe në laboratorë të tjerë, sipas metodikës së testimit të standardit përkatës në fuqi.

2.- inspektorati i jep subjektit përgjigjen e analizave të cilësisë brenda:

a.- 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së mostrës në subjektet e tregtimit me shumicë.

b.- 10 (dhjetë) ditëve kalendarike nga data e marrjes së mostrës në subjektet e tregtimit me pakicë.

c.- 4 (katër) nga marrja e mostrës para zhdoganimit për anijet në терминаlet detare (me përjashtim të Sarandës).

d.- 5 (pesë) nga marrja e mostrës para zhdoganimit për mjetet e transportit tokësor dhe hekurudhor, si dhe anijet në terminalin e Sarandës. Për këto mjete, për efektet të kryerjes së procedurave doganore, konfirmimi për cilësinë e produktit bëhet menjëherë mbi bazën e certifikatës së origjinës dhe vërtetohet përfundimisht nëpërmjet rezultateve të analizave brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike.

3.- Ankimet për rezultate e analizave dhe sanksionet lidhur me to:

a.- për rastet, kur subjekti ka kundërshtim për rezultate e analizave ose për sanksionin e dhënë nga Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre, për cilësinë e produktit të analizuar, ai ka të drejtë të ankohet 10 (dhjetë) nga data e dorëzimit të ketë analizës ose të proces-verbalit të sanksionit të vendosur.

b.- Mbas këtij afati, subjekti humbet te drejtën e ankimit tek kryeinspektori.

c.- Kryeinspektori është i detyruar të kthejë përgjigje brenda 10 ditëve nga paraqitja e ankesës me shkrim.

ç.- Zgjidhja e konfliktit bëhet konform ligjit nr.7697, datë 07.04.1993 “për kundravajtjet administrative”.

II. Mënyrat e marrjes së mostrës dhe sasia e saj.

1.- Mënyra e marrjes së mostrës të bëhet sipas Standardit Shtetëror në fuqi “Nafta dhe produkteve e naftës – Marrja e mostrës STASH 47-86, Grupi A 19”

2.- Marja e mostrës të bëhet në:

a.- Çdo lloj produkti të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre,

b.- Çdo depozitë dhe magazinë të tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre,

c.- Çdo stacion të shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikant,

d.- Çdo stacion dhe njësi të shitjes së lëndëve djegëse, për përdorim residencial të konsumatorëve,

dh.- Çdo lloj mjeti që transporton naftë, gaz dhe nënprodukte të tyre.

3.- Sasia e mostrës e nevojshme për kryerjen e analizave e ruajtjen e saj të jetë:

a.- Për Gazoilin, benzinën e vajgurin:

Deri 4.5 litra (katër litra e gjysmë) për Inspektoratin, gjatë të cilat 3 (tre) litra për analizat në laborator dhe 1.5 litra (një litër e gjysmë) për ruajtjen në laboratorin e tij. Subjektit i lihet në ruajtje 1.5 litra.

b.- Për gazin e lëngshëm të naftës:

Dy bombola, në sasinë 3 litra secila, një për ISHKNG, dhe një për ruajtje tek subjekti.

c.- Për të gjitha nënproduktet e tjera:

3 (tre) litra, nga të cilat 1 (një litër) për analizë dhe 2 (dy) litra për ruajtje (një në Inspektoriale dhe 1 në subjekt)

4.- Mostrat merren nga I.SH.K.N.G në prani të paktën të njërit prej pronarit, përfaqësuesit të subjektit, shitësit të produktit ose magazinierit, si më poshtë:

a.- Për rafineritë e naftës, jo më pak se 3 (tre) here për çdo produkt në shitje për një cikël prodhimi.

b.- për impiantet e përpunimit të nënprodukteve të naftës, për çdo cikël prodhimi, për çdo lloj vaji, por jo më pak se 4 herë në vit.

c.- Për shoqëritë e tregtimit me shumicë të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre:

· Për çdo kontingjent importi detar në pikat doganore për çdo produkt dhe për çdo ndarje të anijes

· Për çdo kontingjent impianti hekurudhor për çdo produkt dhe për çdo vagon

- Për çdo sasi furnizimi të brendshëm (nga rafineritë ose subjektet e shumicës)

· Jo më pak se 1 herë në 4 (katër) muaj, në depozitat e tyre, në pronësi ose përdorim

· Për çdo automjet që transporton naftë, gaz dhe nënproduktet e tyre, që futen nga importi nga pukat doganore

ç.- Për degët e “ARMO” sh.a :

· Jo më pak se në 3 (tre) muaj veprimtari shitje për çdo produkt.

d.- Për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikant, si edhe për stacionet dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për përdorim rezidencial të konsumatorëve, jo më pak se një herë në vit për çdo produkt.

dh.- Për çdo rast të veçantë që me urdhër të kryeinspektorit merret mostër për sondazh, brenda ose jashtë orarit të punës.

- e.- Për rezervat e sigurisë: Sipas detyrave të caktuara nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.
- 5.- Në të gjitha raste së bashku me mostrën merret edhe një kopje e certifikatës së cilësisë dhe e origjinës së produktit.
- 6.- Ambalazhet për marrjen e mostrave të karburanteve të lëngëta të jenë të pastra, të thata dhe një përdorshme, ndërsa për gazin të jenë bombola
- a.- Ambalazhi të sigurohet nga I.SH.K.N.G-ja.
- b.- Për çdo mostër që merret, mbahet proces-verbal. Nëse subjekti refuzon ta nënshkruaj, inspektori bën shënimin “refuzon firmën” duke e bërë të vlefshëm proces verbalin e marrjes së mostrës vetëm me firmën e tij.
- c.- Mostra merret me të njëjtin ambalazh, hermetizohet, sekretohet në praninë dhe firmosjen e dy palëve, si dhe pajiset me etiketën përkatëse të identifikimit. Nëse subjekti refuzon nënshkrimin, ai konsiderohet i vlefshëm me nënshkrimin e inspektorit, gjë e cila pasqyrohet edhe në proces-verbal.
- ç.- Në rast se subjekti nuk lejon të merret mostër, të bashkëpunohet me organet e rendit për realizimin e detyrës shtetërore të kontrollit të cilësisë.
- d.-Mostra administrohet në Inspektoratin Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre, konform urdhërave të brendshëm të nxjerrë nga Kryeinspektori.
- dh.-Mostrat në ruajtje në inspektoriat e në subjekt, analizat e të cilave kanë rezultuar jashtë “rregullave teknike”, duhet të likuidohen vetëm mbas zgjidhjes përfundimtare të ankesës së subjektit sipas afateve të caktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
- e.- Mbas përfundimit të afatit për ruajtje për të cilat nuk ka kontestime nga subjektet, i lihet në kompetencë I.SH.K.N.G për përdorim sipas rregullave financiare në fuqi.

III. Pagesat për kryerjen e analizave.

- 1.- Mostrat për kryerjen e analizave dhe për ruajtje meren pa pagesë.
- 2.- Tarifat për kryerjen e analizave laboratorike vendosen nga ministri përgjegjës për hidrokarburet, me propozim të këshillit drejtues Inspektoratin Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre.
- 3.- Stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm për automjete dhe vajrave lubrifikant si edhe për stacionet dhe njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, për përdorim rezidencial të konsumatorëve, paguajnë në vit vetëm nga një tarifë për kryerjen e analizave laboratorike për çdo produkt tregtimi, ndërsa subjektet e tregtimit me shumicë, me përjashtim të sondazheve, për çdo analizë të kryer.
- Pagesa e tarifës është e detyrueshme dhe duhet të bëhet brenda 15 ditëve nga data e dhënies së përgjigjes së analizës subjektit, ndërsa për importet, para zhdoganimit.

IV. Dokumentacioni për marrjen e mostrës, kryerjen e analizave dhe pagesat.

Dokumentacioni për marrjen e mostrës, kryerjen e analizave dhe pagesat përbëhet nga:

- a.- Proçes-verbali për marrjen e mostrës,
- b.- Certifikata e origjinës dhe cilësisë lëshuar nga shitësi,
- c.- Certifikata e cilësisë së produktit të analizuar në laboratorin e I.SH.K.N.G,
- ç.- Mandat arkëtimi dhe fatura e TVSH,
- d.- Proçes-verbali i përshkrimit të rezultateve të analizës laboratorike,
- dh.- Vendimi i gjobës.

V. Kontrolli për respektimin e normave dhe kushteve teknike.

- 1.- Përdorimi i çdo depozite, magazine, impianti, linja apo pajisje teknologjike që shërben për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre, bëhet vetëm pasi të jetë kontrolluar dhe pajisur nga Inspektoratin Shtetëror të Kontrollit të Naftës, Gazit dhe Nënprodukteve të Tyre, me vërtetim teknik, konform normave dhe kushteve teknike të miratuara nga ministri përgjegjës për hidrokarburet.
- 2.- Tarifat për kontrollin dhe pajisjen me vërtetim teknik, si dhe për konsulentët teknike, vendosen nga Këshilli Drejtues i I.SH.K.N.G., sipas llojit të lejes, kapaciteteve të depozitimit, numrit të rezervuarëve si dhe pajisjeve të shitjes së tyre.

VI. Urdhri i Ministrit të industrisë dhe Energjitikës nr.111, datë 09.06.2003 “për kontrollin e cilësisë, mënyrën e marrjes së mostrës, sasinë e saj, pagesat për analizat, si dhe dokumentacioni përkatës”, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI
VIKTOR DODA**